

VENDIM
Nr. 202, datë 4.4.2025

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 298, DATË 20.4.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
AGJENCISË KOMBËTARE TË TURIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 298, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas pikës 8.5 shtohen pikat 8.5/1 dhe 8.5/2, me këtë përmbajtje:

“8.5/1. “Harton, në bashkëpunim me institucionet qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe grupet e interesit në fushën e turizmit, kalendarin turistik të aktiviteteve zbavitëse, duke i orientuar ato për shtrirjet gjeografike, si dhe për tematikën e eventeve të preferuara për turistët në këto zona dhe duke koordinuar njëkohësisht edhe realizimin e këtij kalendari.

8.5/2. Orienton, koordinon dhe promovon kalendarin turistik, si dhe monitoron ndjekshmërinë nga publiku të aktiviteteve të këtij kalendari.”.

b) Pas pikës 8.6 shtohen pikat 8.6/1 dhe 8.6/2, me këtë përmbajtje:

“8.6/1. Financon nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit realizimin e projekteve të cilat kanë karakter krijues e me objekt të veprimtarisë së tyre turizmin, si dhe ngjarje që janë të përfshira në kalendarin turistik, pas miratimit të ministrit.

8.6/2. Monitoron zbatimin dhe realizimin e projekteve me karakter krijues, të cilat kanë për qëllim promovimin e turizmit, si dhe të ngjarjeve që janë të përfshira në kalendarin turistik, të financuara nga fondi buxhetor i miratuar.”.

c) Pas pikës 8.12 shtohet pika 8.12/1, me këtë përmbajtje:

“8.12/1. Krijon të ardhura dytësore nga pagesat e subjekteve të cilave u ofrohet shërbimi i promovimit të aktiviteteve të tyre në hapësirat e menaxhuara nga Agjencia Kombëtare e Turizmit.”.

2. Në pikën 2, të kreut IV, emërtesa “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohet me “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”.

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku